

VENDIM
Nr. 439, datë 20.5.2015

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH PËR SHPENZIME KAPITALE, NDËRMJET
PROGRAMEVE, BRENDA BUXHETIT TË VITIT 2015, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E MJEDISIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve për shpenzime kapitale, ndërmjet programeve, brenda buxhetit të vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Mjedisit, si më poshtë vijon:

a) Në programin “Administrimi i pyjeve” shtohet fondi në vlerën 12000000 (dymbëdhjetë milionë) lekë, për investim në projektin “Parandalimi i zjarreve dhe prerjeve të paligjshme në pyje në Qarkun e Tiranës”;

b) Në programin “Mbrojtja e mjedisit” pakësohet fondi në vlerën 4425000 (katër milionë e katër qind e njëzet e pesë mijë) lekë, për kosto lokale për projektin “Kune-Vain/UNEP”, për vitin 2015;

c) Në programin “Mbrojtja e mjedisit” pakësohet fondi për projektin “IPA 2013–Ndryshimet klimaterike”, në vlerën 2666500 (dy milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) lekë, për kosto lokale, dhe TVSH në vlerën 2000000 (dy milionë) lekë;

ç) Në programin “Mbrojtja e Mjedisit” pakësohet fondi për projektin “IPA 2013–Mbetjet”, në vlerën 2666500 (dy milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) lekë, për kosto lokale, dhe TVSH në vlerën 242000 (dyqind e dyzet e dy mijë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama